

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda**, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarëve I. S., nga fshati J. të Z. – Republika e Sërbisë, Xh. H. nga Shkupi – Republika e Maqedonis dhe K. B. nga fshati V. të Shkupit – Republika e Maqedonisë, për shkak të veprës penale faksifikimi i parasë nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.27/18 të datës 13.06.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë në prezencën e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të akuzuarëve dhe mbrojtësve të tre av.B. B., O. Z. dhe H. S.,av.nga Prizreni, me datën 12.09.2018, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**I.I. S.**, nga i ati S. dhe nëna L. e gjinisë D., i lindur më data e lindjes... në J. të Z. të republikës së sërbiisë, ku edhe tani jeton,, sërb, shtetas i Republikës së sërbiisë, zdrukthtar, i gjendjes së mesme ekonomike, gjindet në paraburgim prej datës 10.03.2018

**II.D. H.**, nga i ati A. dhe e ëma H., e gjinisë H., i lindur më data e lindjes... në Shkup të Republikës së Maqedonisë, ku edhe tani jeton, menaxher i firmës “Prikolica Serin Treilers” me seli në Shkup, e ka të kryer fakultetin juridik, i gjendjes së mesme ekonomike, boshnjak, - shtetas i Republikës së Maqedonisë, gjindet në paraburgim prej datës 10.03.2018.

**III.K. B.**, nga i ati A. dhe e ëma F., e gjinisë I. i lindur më data e lindjes... në fsh.B. të Shkupit, ku edhe tani jeton, punëtr i sigurimit,e ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar i ati i dy fëmijëve, shqiptar shtetas i Republikës së Maqedonisë, gjindet në paraburgim prej datës 10.03.2018.

**JANË FAJTOR**

Pas marrëveshjes paraprake e duke ditur për paratë e falsifikuara, ato i vejnë në qarkullim, në atë mënyrë që më datë 10.03.2018 nga repu lika e Maqedonisë hyjnë në teritorin e Republikës së Kosovës, me automjetin e markës “BMV X 5”, ngjyrë hiri, me targa *numri i targës...*, të cilin e drejtonte i akuzuari D. H., pronë e vëllaut të tij, në të cilin automjet ishin të akuzuarit K. B. dhe I. S., ku ky i fundit i kishte të fshehura në njëpliko në xhep të kanës së tij 36 kartëmonedha të falsifikuara nga 200 Euro, ku në 8 vende janë identifikuar 8 të dëmtuar si më poshtë, ndërsa në 11 raste tjera nuk janë identifikuar të dëmtuarit, asisoj që kur rrethë orës 11:55 minuta arrinë në fsh.R. – Komuna e Prizrenit, të akuzuarit I. dhe K. dalin nga automjeti, ndërsa i akuzuari D. i pret në automjet, hyjnë në marketin “R.” pronë e të dëmtuarit S. S., blejnë dy pako të napolitankave dhe dy pako të cigareve “Leck Strike”, punëtores së lokalit ia japin partëmoedhën e falsifikuar prej 200 Euro, me nr.serik Y11442441200 dhe pasi marrin kusurin largohen e pastja në mënyrën e njëjtë rrethë orës 12:00, në fsh.R. hyjnë në arnatoren “Te Farm Aspirin C”, pronë e të dëmtuarit A. T., i blejnë medikamentet “Brufen” dhe “Aspirin C” në vlerë prej 3.40 Euro e pastaj punëtores ia japin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro me nr.serik X00339378249 dhe pasi marrin kusurin ikin me shpejtësi nga vendi i ngjarjes dhe arrinë në Prizren ku rreth orës 13:30 minuta duke përdorë sistemin e njëjtë dhe derisa i akuzuari D. i priste në vendin e caktuar, të akuzuarit I. dhe K. hyjnë në butikun “Butchue” në Sheshin “Shadërvan” në Prizren, jpronë e të dëmtuarit N. P., ku nga punëtorja blejnë gjësende në vlerë prej 25 Euro, të cilës ia japin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro me nr.serik Y 1033915060 dhe pasi marrin kusurin largohen e pastaj rrethë orës 15:30 minuta shkojnë në mishtoren “Xhoshkkun” në rrugën ... në Prizren pronë e të dëmtuarit B. D., ku aty blejnë mish në vlerë prej 20 Euro të cilit ia jepin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro, me nr.sereik Y11442440941 dhe pasi marrin kusiurin nga ai me shpejtësi largohen, e pastaj aty afër shkojnë në Sheshin “Shadërvan” të një tezgë – shitës ambulatorë, ku nga i dëmtuari B. K. blejnë një qantë të vogël kahu me ngjyrë të zezë me një shirit në mes me ngjyrë të kuqe në të gjelbërt të markës “Guci” në vlerë prej 10 Euro, ja japin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro, me nr.serik Y11442441793, e pastaj shkojnë në DPT “Reshani” dhe nga e dëmtuara F. Z. blejnë një çantë krahu të modelit “Guci” me ngjyrë të zezë dhe hiri, me çmim prej 10 Euro, ia japin kartëmonedhën e falsifikuar me numër serik Y11442441239, pasi marrin kusurin largohen nga aty e pastaj që të tre të akuzuarit me automjetin e lartpërmendur shkojnë në mishtoren “Shantiri”, në Lagjen “B.”, aty blejnë 1 kgr.sugjuk dhe 1.kgr.mish të terur, shitësit ia japin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro me nr.serik Y12553552068, pasi e marrin kusurin largohen nga aty e pastja rrethë orës 15:00, shkojnë në barnatoren “Multi 3” në rrugën në Prizren dhe pasi blejnë në pako pampersa dhe një vitamin C në vlerë prej 6.20 Euro, ia japin të dëmtuarës I. A., kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro, me nr.serik Y10339215642, kurse në 14 artikujt tjerë të të dëmtuarëve të pa identifikuar , i kanë fut në përdorim 11 bankënota të falsifikuara nga 200 Euro, duke blerë një kantë me ngjyrë “Jupoll” në peshë prej 15 litra, 1 tops “Hay hay”, 1 qips “Chipsy XXL”, një enë çelqi me 800 gr.mjalët. një bluzë, 1 palë doëza, 4 kanaqe birra “Tuborg” 2, kanaqe birra “llashko”, një top të kuq i madh, 1 top i laltër i vogël, 6 pako duhan “Marlboro Wihte, 7 pako duhan “Camel”, 2 lugë të vogla druri, 9 pako duhan “Lucky Strike” dhe 1 vitamin C, në vlerë prej 2200

Euro, e pastjaj që të tre largohen nga vendi i ngjarjes, ku më vonë kapen nga policia në Shtimje.

-këso dore bashkëkryejnë veprën penale faksifikimi i parasë nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KPRK.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 7, 17, 41, 45, 46, 47, 73,80, në lidhje me nenin 428 par.1. të KP i

## **G J Y K O N**

Të akuzuarit I. S.:

Për veprën penale faksifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve.

Konformë nenit 47 të KP në pajtim me të akuzuarin dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtu që i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 7.500 Euro,në të cilin dënim me burgim do ti llogarritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.03.2018 gjer në në ditën e lirit nga paraburgimi,ashtuqë një ditë burgim do të llogarritet 20 Euro.

Obligohet i akuzuari që dënimin me gjobë ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotëftuqishmërisë së aktgjykimit.Poqese i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë gjykata do të ia zëvendësoi dënimin me gjobë në dënimin me burgim, ashtuqë një ditë burgim do të llogaritet me 20 Euro gjobë.

Të akuzuarit Xh. H.:

Për veprën penale faksifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 muajve.

Konformë nenit 47 të KP në pajtim me të akuzuarin dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtu që i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 5.500 Euro,në të cilin dënim me burgim do ti llogarritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.03.2018 gjer në në ditën e lirit nga paraburgimi,ashtuqë një ditë burgim do të llogarritet 20 Euro.

Obligohet i akuzuari që dënimin me gjobë ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotëftuqishmërisë së aktgjykimit.Poqese i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë gjykata do të ia zëvendësoi dënimin me gjobë në dënimin me burgim, ashtuqë një ditë burgim do të llogaritet me 20 Euro gjobë.

Të akuzuarit K. B.:

Për veprën penale falsifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 muajve.

Konformë nenit 47 të KP në pajtim me të akuzuarin dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtu që i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 5.500 Euro,në të cilin dënim me burgim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.03.2018 gjer në ditën e lirit nga paraburgimi,ashtuqë një ditë burgim do të llogaritet 20 Euro.

Obligohet i akuzuari që dënimin me gjobë ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.Poqese i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë gjykata do të ia zëvendësoi dënimin me gjobë në dënimin me burgim, ashtuqë një ditë burgim do të llogaritet me 20 Euro gjobë.

Të dëmtuarit S. S.,A. T.,N. P.,B. D. dhe B. K. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Në bazë të Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjit nr.05/L-36 për kompenzimin e viktimave të krimit të datës 30.01.2018, obligohen të akuzuarit I. S., Xh. H. dhe K. B. që secili prej tyre konformë nenit 39 të Ligjit të lartëcekur të paguajnë shumën prej nga 50 Euro, në Fondin për kompenzimin e viktimave të krimit.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushalit gjyqësor secili prej tyre të paguajnë shumën prej nga 150 Euro, në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti për krime të rënda kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.27/18 të datës 13.06.2018, kundër të akuzuarve I. S., nga fshati J. të Z. – Republika e Sërbisë, Xh. H. nga Shkupi – Republika e Maqedonis dhe K. B. nga fshati V. të Shkupit – Republika e Maqedonisë, për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP.Më datën 17.08.2018 Prokuroria e Shtetit në Prizren ka parashtruar edhe marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajsisë me të akuzuarit.

Gjatë shqyrtimit të dytë Prokurori i Shtetit Metush Biraj ka propozuar që marrëveshja mbi pranimin e fajsisë të aprovohet në tërësi nga gjykata.

I akuzuari I. S. e ka pranuar fajsinë për veprën penale falsifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP dhe ka cekur se me Prokurorinë e shtetit kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajsisë në prezenc të mbrojtëses B. B., nga ana e Prokurorit të Shtetit i është shpjeguar natyra dhe pasojat e arritjes së marrëveshjes, marrëveshjen e ka nënshkruar me vullnetin e lirë pa kurrfarë presioni dhe kërcnimi dhe se është dakorduar me dënimin e rekomanduar nga ana e Prokurorit të shtetit duke propozuar që gjykata ta aprovon marrëveshjen e arritur.

Mbrojtësja e të akuzuarit I. S., avokat B. B. ka propozuar që marrëveshja të aprovohet, me çka është pajtuar edhe vet i akuzuari.

I akuzuari Xh. H. e ka pranuar fajsinë për veprën penale falsifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP dhe ka cekur se me Prokurorinë e shtetit kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajsisë në prezenc të mbrojtëses B. B., nga ana e Prokurorit të Shtetit i është shpjeguar natyra dhe pasojat e arritjes së marrëveshjes, marrëveshjen e ka nënshkruar me vullnetin e lirë pa kurrfarë presioni dhe kërcnimi dhe se është dakorduar me dënimin e rekomanduar nga ana e Prokurorit të shtetit duke propozuar që gjykata ta aprovon marrëveshjen e arritur.

I akuzuari K. B. e ka pranuar fajsinë për veprën penale falsifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP dhe ka cekur se me Prokurorinë e shtetit kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajsisë në prezenc të mbrojtëses B. B., nga ana e Prokurorit të Shtetit i është shpjeguar natyra dhe pasojat e arritjes së marrëveshjes, marrëveshjen e ka nënshkruar me vullnetin e lirë pa kurrfarë presioni dhe kërcnimi dhe se është dakorduar me dënimin e rekomanduar nga ana e Prokurorit të shtetit duke propozuar që gjykata ta aprovon marrëveshjen e arritur.

Në shqyrtimin e dytë të akuzuarit I. S., Xh. H. dhe K. B. e kanë pranuar fajsinë për veprë penale falsifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP, andaj, edhe gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësise dhe marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajësise, i cili pranim është bërë konformë nenit 233 par.18 të KPP, të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë, pranimi i fajsisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve me mbrojtësit e tyre, pranimi i fajsisë mbështetet në fakte dhe prova materijale të rastit konkret dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 par.2. të KPP dhe se gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve formohen elementet qenësore të veprës penale falsifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 302 par.2.lidhur me nenin 31 të KP pasi që Pas marrëveshjes paraprake e duke ditur për paratë e falsifikuara, ato i vejnë në qarkullim, në atë mënyrë që më datë 10.03.2018 nga repu lika e Maqedonisë hyjnë në teritorin e Reublikës së Kosovës, me automjetin e markës “BMV X 5”, ngjyrë hiri, me targa *numri i targës...*, të cilin e drejtonte i akuzuari D. H., pronë e vëllaut të tij, në të cilin automjet ishin të

akuzuarit K. B. dhe I. S., ku ky i fundit i kishte të fshehura në njëpliko në xhep të kanës së tij 36 kartëmonedha të falsifikuara nga 200 Euro, ku në 8 vende janë identifikuar 8 të dëmtuar si më poshtë, ndërsa në 11 raste tjera nuk janë identifikuar të dëmtuarit, asisoj që kur rrethë orës 11:55 minuta arrinë në fsh.R. – Komuna e Prizrenit, të akuzuarit I. dhe K. dalin nga automjeti, ndërsa i akuzuari D. i pret në automjet, hyjnë në marketin “Rame” pronë e të dëmtuarit S. S., blejnë dy pako të napolitankave dhe dy pako të cigareve “Leck Strike”, punëtores së lokalit ia japin partëmoedhën e falsifikuar prej 200 Euro, me nr.serik Y11442441200 dhe pasi marrin kusurin largohen e pastja në mënyrën e njejtë rrethë orës 12:00, në fsh.R. hyjnë në arnatoren “Te Farm Aspirin C”, pronë e të dëmtuarit A. T., i blejnë medikamentet “Brufen” dhe “Aspirin C” në vlerë prej 3.40 Euro e pastaj punëtores ia japin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro me nr.serik X00339378249 dhe pasi marrin kusurin ikin me shpejtësi nga vendi i ngjarjes dhe arrinë në Prizren ku rreth orës 13:30 minuta duke përdorë sistemin e njëjtë dhe derisa i akuzuari D. i priste në vendin e caktuar, të akuzuarit I. dhe K. hyjnë në butikun “Butchue” në Sheshin “Shadërvan” në Prizren, jpronë e të dëmtuarit N. P., ku nga punëtorja blejnë gjësende në vlerë prej 25 Euro, të cilës ia japin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro me nr.serik Y 1033915060 dhe pasi marrin kusurin largohen e pastaj rrethë orës 15:30 minuta shkojnë në mishtoren “Xhoshkkun” në rrugën ... në Prizren pronë e të dëmtuarit B. D., ku aty blejnë mish në vlerë prej 20 Euro të cilit ia jepin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro, me enr.sereik Y11442440941 dhe pasi marrin kusurin nga ai me shpejtësi largohen, e pastaj aty afër shkojnë në Sheshin “Shadërvan” të një tezgë – shitës ambulatorë, ku nga i dëmtuari B. K. blejnë një qantë të vogël kahu me ngjyrë të zezë me një shirit në mes me ngjyrë të kuqe në të gjelbërt të markës “Guci” në vlerë prej 10 Euro, ja japin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro, me nr.serik Y11442441793, e pastaj shkojnë në DPT “Reshani” dhe nga e dëmtuara F. Z. blejnë një çantë krahu të modelit “Guci” me ngjyrë të zezë dhe hiri, me çmim prej 10 Euro, ia japin kartëmonedhën e falsifikuar me numër serik Y11442441239, pasi marrin kusurin largohen nga aty e pastaj që të tre të dkuzuarit me automjetin e lartpërmendur shkojnë në mishtoren “Shantiri”, në Lagjen “B.”, aty blejnë 1 kgr.sugjuk dhe 1.kgr.mish të terur, shitësit ia japin kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro me nr.serik Y12553552068, pasi e marrin kusurin largohen nga aty e pastja rrethë orës 15:00, shkojnë në barnatoren “Multi 3” në rrugën ... në Prizren dhe pasi blejnë në pako pampersa dhe një vitamin C në vlerë prej 6.20 Euro, ia japin të dëmtuarës I. A., kartëmonedhën e falsifikuar prej 200 Euro, me nr.serik Y10339215642, kurse në 14 artikujt tjerë të të dëmtuarëve të pa identifikuar , i kanë fut në përdorim 11 bankënota të falsifikuara nga 200 Euro, duke blerë një kantë me ngjyrë “Jupoll” në peshë prej 15 litra, 1 tops “Hay hay”, 1 qips “Chipsy XXL”, një enë çelqi me 800 gr.mjalët. një bluzë, 1 palë doëza, 4 kanaqe birra “Tuborg” 2, kanaqe birra “llashko”, një top të kuq i madh, 1 top i laltër i vogël, 6 pako duhan “Marlboro Wihte, 7 pako duhan “Camel”, 2 lugë të vogla druri, 9 pako duhan “Lucky Strike” dhe 1 vitamin C, në vlerë prej 2200 Euro, e pastaj që të tre largohen nga vendi i ngjarjes, ku më vonë kapen nga policia në Shtimje.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 41 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë,motivet nga të cilat është kryer

vepra penale, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajsinë dhe kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, nuk kanë qenë përpara të dënuar për ndonjë veprë penale, se është hera e parë që bien në kundërshtim me ligjin, mbajtjen korrekte të tyre në gjykim, se janë të martuar dhe kanë fëmijë. Pasi që rrethana rënduese nuk gjeti, andaj është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrij qëllimin e vet konformë nenit 41 të KP, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarve ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit në të gjitha segmentet e saj.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro-juridike është marrë konformë nenit 463 par.2. të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti për krime të rënda**  
**Më dt.12.09.2018.PKR.nr.49/18**

**Proçesmbajtësja**  
**Sheqere Braha**

**Kyetarja e trupit gjykues**  
**Ajser Skenderi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Pasi që palët me të drejtë ankese kanë hjekur dorë nga e drejta e ankesës, andaj, ky aktgjykim me datën e shpalljes më datën **12.09.2018 bëhet i plotëfuqishëm.**